



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “KARPENTIERI,
HEKURKTHIM DHE BETONIM”**

(Niveli III në KSHK¹, referuar Niveli III në KEK²)

Kodi: B3-III-23

TIRANË, 2024

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “**Karpentieri, hekurkthim dhe betonim**”, **Niveli III në KSHK, referuar niveli III në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasën e 12-të, që i përket këtij niveli.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës për përsëritjen dhe kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e arsimit të të gjitha niveleve, këto programe krijojnë mundësinë e verifikimit paraprak të shkallës së përgatitjes përfundimtare të nxënësve brenda një institucioni të caktuar shkollor, i cili mund të realizohet duke zhvilluar testime përmbledhëse.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individëve në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare, është e rëndësishme që herë pas here mësimdhënësit të zhvillojnë testime të individëve, me teste teorike apo praktike, që mund t’i hartojnë vetë. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, si edhe udhëzimet për vlerësimin e individëve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar;
- programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar.

A. Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në profilin mësimor ” **Karpentieri, hekurkthim dhe betonim**”, **Niveli III në KSHK, referuar niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në programet e përgjithshme të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës. Ky program përmban rreth 30 % të vëllimit të orëve të lëndëve profesionale, të zhvilluara në klasën e 12-të.

Lëndët profesionale të përfshira në programin orientues dhe peshat e tyre përkatëse janë:

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Teknologji konstruksionesh e kallëpesh prej druri	40	52
2	Teknologji konstruksionesh prej betoni të armuar	36	48
	TOTALI	76	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) Temat nga lënda “**Teknologji konstruksionesh e kallëpesh prej druri**”, kl.12:
Gjithsej 40 orë

Tema 2	Teknologjia e ndërtimit të konstruksionit mbajtës të çatisë prej druri	8 orë
Tema 3	Teknologjia e ndërtimit të kapriatës së thjeshtë prej druri	8 orë
Tema 8	Teknologjia e ndërtimit të kallëpit të themeleve prej betoni të armuar	4 orë
Tema 9	Teknologjia e ndërtimit të kallëpit të mureve dhe shtyllave prej betoni të armuar	4 orë
Tema 10	Teknologjia e ndërtimit të kallëpit të trarëve dhe pllakave prej betoni të armuar	8 orë
Tema 11	Teknologjia e ndërtimit të kallëpit të shkallëve prej betoni të armuar	8 orë

- b) Temat nga lënda “**Teknologji konstruksionesh prej betoni të armuar**”, kl.12 :
Gjithsej 36 orë

Tema 1	Konstruksionet mbajtëse dhe elementet konstruktive të tyre	4 orë
Tema 2	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në përkulje (pllaka dhe trarë)	10 orë
Tema 3	Parimet bazë për konstruktimin e elementeve prej betoni të armuar që punojnë në shtypje (shtylla dhe mure)	6 orë
Tema 4	Parimet bazë për konstruktimin e themeleve prej betoni të armuar (pllakë, trarë dhe plinta)	6 orë
Tema 5	Parimet bazë për konstruktimin e shkallëve prej betoni të armuar	6 orë
Tema 6	Konstruksionet prej betoni të armuar të parapërgatitura	2 orë
Tema 7	Konstruksionet prej betoni të armuar gjysmë të parapërgatitura	2 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, që zgjat 1.5 (një presje pesë) orë dhe përgatitet nga Komisioni i Vlerësimit të Provimit Përfundimtar të profilit të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve të përgatitura nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tri nivele, si më poshtë:

Model i shpërndarjes së pikëve për pyetje të niveleve të ndryshme në test

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Teknologji konstruksionesh e kallëpesh prej druri	52	31	12	12	7
2	Teknologji konstruksionesh prej betoni të armuar	48	29	12	12	5
TOTALI		100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësiti e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësiti me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësiti me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 14	4
15 - 21	5
22 - 29	6
30 - 36	7
37 - 43	8
44 - 52	9
53 - 60	10

B. Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në profilin mësimor ”**Karponentieri, hekurkthim dhe betonim**”, **Niveli III në KSHK, referuar niveli III në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

a) Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, detyrat e punës dhe pikët për secilën kompetencë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Të kryej proceset parapërgatitore.	1. Realizimi i një ose më shumë hapave si: të interpretojnë fletët e projektit, skicat, detajet e ndryshme për punime karponentieri, hekurkthim dhe betonim, të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve sipas proceseve të punës që do kryhet; të përzgjedhin veglat, makineritë, instrumentet e mjetet sipas procesit të punës , të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve, të përzgjedhin bazën materiale sipas procesit të punës, të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës; të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë.	5
2.	Të kryej punime kallëpesh për elemente betonarme (plintit, shtyllave, mureve).	2. Realizimi i një ose më shumë hapave si: të kontrollojnë kuotën, akset sipas modinave, përmasat e tabanit me instrumente matëse e niveluese, sipas fletës së projektit të plintit, shtyllave, mureve; të matin, shënojnë dhe presin elementet (faqet) e kallëpit të plintit, shtyllave, mureve sipas skicës; të montojnë dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shkallëzimit të parë dhe ta përforcojnë kallëpin; të montojnë dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shkallëzimit të dytë, ta fiksojnë mbi shkallëzimin e parë pas vendosjes së skarës së hekurit e fitilave dhe ta përforcojnë atë duke kontrolluar akset me spango dhe plumbçe; të montojnë dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shtyllës, murit kontrolluar akset me spango dhe plumbçe; të përforcojnë kallëpin e tyre sipas kushteve teknike.	30
3.	Të kryej përgatitjen e hekurit për elemente betonarme(plintit, shtyllave, mureve).	3. Realizimi i një ose më shumë hapave si: të shpërndajnë hekurin në vendin e punës; të vendosin skelerinë ndihmëse për punime në elemente të ndryshëm betonarme; të vendosin shabllonet për elementet vertikal; të vendosin aksesorë lidhës (pjastra, shufra metalike, ganxha, rrjeta speciale etj.) në elemente b/a; të	15

		vendosin për shtresën mbrojtëse rula Ø20 të hekurit në kallëpet e elemente b/a	
4.	Të kryej punime të elementeve konstruktive prej betoni të armuar (plintit, shtyllave, mureve).	4. Realizimi i një ose më shumë hapave si: të matin, shënojnë dhe presin shufrat e hekurit për skarën dhe fitilat e plintit, shufrat e hekurit vertikale të kolonës, murit prej b/a; të drejtojnë, matin, shënojnë, presin shufrat e hekurit për stafat e hapura e mbyllura; të kthejnë shufrat e hekurit për stafat për kolonën, plintin, e murin b/a; të lidhin shufra e hekurit të skarës, për (fitilat me stafat), të lidhin midis tyre me skarat me stafat e hapura të murit b/a; të fiksojnë tejpërtej distancatorët metalikë pas vendosjes së faqes së dytë të kallëpit të murit b/a.	30
5.	Të kryej punime betonimi (plintit, shtyllave, mureve) dhe trajtimi pas betonimit.	5. Realizimi i një ose më shumë hapave si: të kontrollojnë pozicionin e shufrave dhe shtresën mbrojtëse sipas kushteve teknike të zbatimit; të pastrojnë, lagin kallëpet dhe të vendosin lugun për betonim; të përgatitin betonin me krahë/makineri sipas markave respektive (plintit, shtylla, mureve); të hedhin, ngjeshin dhe rrafshojnë betonin në kallëpe; të vibrojnë betonin në elementet prej b/a; të mirëmbajnë në kohën e duhur pas betonimit sipas kushteve teknike; të dizarmojnë në kohën e duhur sipas radhës elementet e kallëpeve të plintit, shtyllat, mureve b/a.	20
Shuma			100

b) Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 – 40	4
41 – 50	5
51 – 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve për “*detyrat e punës*” në grupe pune ose individuale në mjediset e punës (reparti ndërtimit), së shkollës, kompani ndërtimi etj.

- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në çdo detyrë është shumë e domosdoshme të **përfshihen në vlerësim respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.**
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t'i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit, me përjashtim të postit të punës, ku shkalla e rrezikshmërisë është relativisht e lartë.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, pastrimin e vendit dhe mjeteve të punës, përgatitjes së mjeteve, materialeve të punës etj.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.

Përbushja e kompetencës **“Të kryej proceset parapërgatitore”** do të realizohet me **Detyrën 1** në mjediset e punës së shkollës ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t'u sigurohen mjediset e punës, udhëzues, pankarta për faqet e kallëpit të elementeve b/a (plint, shtyllë, mur,) material kanclarie, pajimet, instrumentet matës/nivelues dhe materialet e mëposhtme:

- mjetet e punës të hekurkthyesit, karpentierit e betonistit;
- instrumentet matëse e niveluese,
- kompleti i veshjes së punës,
- skela të gatshme,
- pankarta për punime karpentierie, hekurkthimi dhe betonim të elementeve të ndryshme b/a(plint, shtylla, mure),
- skica/detaje të gatshme për punimet hekurkthimi, karpentierie e betonimi etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete për një ose më shumë hapa si: të interpretojnë fletët e projektit, skicat, detajet e ndryshme për punime karpentieri, hekurkthim dhe betonim, të kryejnë llogaritje të volumeve dhe materialeve sipas proceseve të punës që do kryhet; të përzgjedhin veglat, makineritë, instrumentet e mjetet sipas procesit të punës, të përcaktojnë radhën e kryerjes së punimeve, të përzgjedhin bazën materiale sipas procesit të punës, të kontrollojnë dhe sigurojnë gjendjen teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; të pastrojnë e sistemojnë paraprakisht vendin e punës; të sigurojnë ndriçimin e duhur dhe furnizimin me ujë.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: interpretimi i fletëve të projektit, skicave, detajeve të ndryshme për punime karpentieri, hekurkthim dhe betonim, llogaritja e volumeve dhe materialeve sipas proceseve të punës që do kryhet; përzgjedhja e veglave, makinerive, instrumenteve e mjeteve sipas procesit të punës, përcaktimi i radhës së kryerjes së punimeve, përzgjedhja e bazës

materiale sipas procesit të punës, kontrolli dhe sigurimi i gjendjes teknike të mjeteve, veglave dhe instrumenteve të punës; pastrimi e sistemimi paraprak i vendit të punës; sigurimi i ndriçimit të duhur dhe furnizimit me ujë.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryej punime kallëpesh për elemente betonarme (plintit, shtyllave, mureve)”** do të realizohet me **Detyrën 2** në mjediset e punës së shkollës ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- mjediset objekt ndërtimi (reparti ndërtimit),
- mjetet e punës,
- materialet për kallëpe: dërrasa 3 cm, panele të gatshme, përforcues, gozhdë, fiksues qafore, shtrëngues,
- skela të gatshme,
- instrumentet matëse e niveluese,
- kompleti i veshjes së punës, s
- harrë dore, spango dhe plumbçe

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete në një ose më shumë hapa si: të kontrollojnë kuotën, akset sipas modinave, përmasat e tabanit me instrumente matëse e niveluese, sipas fletës së projektit të plintit, shtyllave, mureve; të matin, shënojnë dhe presin elementet (faqet)e kallëpit të plintit, shtyllave, mureve sipas skicës; të montojnë dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shkallëzimit të parë dhe ta përforcojnë kallëpin; të montojnë dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shkallëzimit të dytë, ta fiksojnë mbi shkallëzimin e parë pas vendosjes së skarës së hekurit e fitilave dhe ta përforcojnë atë duke kontrolluar akset me spango dhe plumbçe; të montojnë dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shtyllës, murit kontrolluar akset me spango dhe plumbçe; të përforcojnë kallëpin e tyre sipas kushteve teknike. Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: kontrolli kuotës, akseve sipas modinave, përmasat e tabanit me instrumente matëse e niveluese, sipas fletës së projektit të plintit, shtyllave, mureve; matja, shënimi dhe prerja elementeve (faqeve) të kallëpit të plintit, shtyllave, mureve sipas skicës; montimi dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shkallëzimit të parë dhe përforcimi kallëpit; montimi dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shkallëzimit të dytë, fiksimi mbi shkallëzimin e parë pas vendosjes së skarës së hekurit e fitilave dhe përforcimi tyre duke kontrolluar akset me spango dhe plumbçe; montimi dy e nga dy dhe midis tyre faqet e shtyllës, murit e kontrolli akseve me spango dhe plumbçe; përforcimi i kallëpit të tyre sipas kushteve teknike.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryej përgatitjen e hekurit për elemente betonarme (plintit, shtyllave, mureve)”** do të realizohet me **Detyrën 3** në mjediset e punës së shkollës ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- mjediset objekt ndërtimi, (reparti ndërtimit),
- materiale kanclarie,
- materialet mjetet e punës,
- instrumentet matëse e niveluese,
- skela të gatshme ndihmëse,
- kompleti i veshjes e veglave të punës,
- hekur, tel bari, elemente hekuri shtesë si: shabllonet për elementet vertikal;
- aksesorë lidhës (pjastra, shufra metalike, ganxha, rrjeta speciale etj.)
- rula Ø20 të hekurit,
- skica të gatshme e fletë projekti etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete në një ose më shumë hapa si: të shpërndajnë hekurin në vendin e punës; të vendosin skelerinë ndihmëse për punime në elemente të ndryshëm betonarme; të vendosin shabllonet për elementet vertikal; të vendosin aksesorë lidhës (pjastra, shufra metalike, ganxha, rrjeta speciale etj.) në elemente b/a; të vendosin për shtresën mbrojtëse rula Ø20 të hekurit në kallëpet e elemente b/a.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: shpërndarja e hekurit në vendin e punës; vendosja skelerisë ndihmëse për punime në elemente të ndryshëm betonarme; vendosja shablloneve për elementet vertikal; vendosja aksesorëve lidhës (pjastra, shufra metalike, ganxha, rrjeta speciale etj.) në elemente b/a; vendosja për shtresën mbrojtëse rula Ø20 të hekurit në kallëpet e elemente b/a

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryej punime të elementeve konstruktivë prej betoni të armuar (plintit, shtyllave, mureve)”**do të realizohet me **Detyrën 4** në mjediset e punës së shkollës ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- mjediset objekt ndërtimi, (reparti ndërtimit),
- pankarta,
- skica të gatshme
- fletë projekti konstruktive plintit, shtyllave, mureve b/a
- instrumentet matëse e niveluese,
- skela të gatshme,
- kompleti i veshjes së punës,
- shënues,
- tranxhë hekuri,
- bango punime hekuri,
- çelës kthimi hekuri,

- metër,
- materialet tel bari, darë, pinca, çekiç/vare, sqepar.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete kryejnë një ose më shumë hapa si: të matin, shënojnë dhe presin shufrat e hekurit për skarën dhe fitilat e plintit, shufrat e hekurit vertikale të kolonës, murit prej b/a; të drejtojnë, matin, shënojnë, presin shufrat e hekurit për stafat e hapura e mbyllura; të kthejnë shufrat e hekurit për stafat për kolonën, plintin, e murin b/a; të lidhin me tel bari shufra e hekurit të skarës, për (fitilat me stafat), të lidhin midis tyre me skarat me stafat e hapura të murit b/a; të fiksojnë tejpërtej distancatorët metalikë pas vendosjes së faqes së dytë të kallëpit të murit b/a.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, komisioni i vlerësimit duhet të verifikojë shkallën e arritjeve të shprehive praktike si: matja, shënimi dhe prerja e shufrave të hekurit për skarën dhe fitilat e plintit, shufrat e hekurit vertikale të kolonës, murit prej b/a; drejtimi, matja, shënimi dhe prerja e shufrave të hekurit për stafat e hapura e mbyllura; kthimi i shufrave të hekurit për stafat për kolonën, plintin, e murin b/a; lidhja me tel bari shufra e hekurit të skarës, për (fitilat me stafat), lidhja midis tyre me skarat me stafat e hapura të murit b/a; fiksimi tejpërtej i distancatorëve metalikë pas vendosjes së faqes së dytë të kallëpit të murit b/a.

Instrumentet e vlerësimit do të bëhen me listë kontrolli të përgatitur përpara

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Përmbushja e kompetencës **“Të kryej punime betonimi (plintit, shtyllave, mureve) dhe trajtimi pas betonimit”** do të realizohet me **Detyrën 5** në mjediset e punës së shkollës ose kompani ndërtimi.

Për realizimin e kësaj detyre, nxënësve duhet t’u sigurohen mjediset, pajimet dhe materialet e mëposhtme:

- pankarta për punime betonimi të elementeve prej betoni të armuar (plint, shtylla, mure)
- mjetet e punës dhe instrumentet matëse e niveluese,
- betonierë, kubikë, vibrator, levë hekuri,
- materiale inerte, çimento, ujë, pasqyra të gatshme për markat e betonit,
- kompleti i veshjes së punës,
- skelë e gatshme, lug i gatshëm, zorrë uji, kovë, mistri, govatë, karrocë dore, lopatë, sqepar etj.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale duke u angazhuar në mënyrë konkrete për një ose më shumë hapa si: të kontrollojnë pozicionin e shufrave dhe shtresën mbrojtëse sipas kushteve teknike të zbatimit; të pastrojnë, lagin kallëpet dhe të vendosin lugun për betonim; të përgatitin betonin me krahë/makineri sipas markave respektive (plintit, shtylla, mureve); të hedhin, ngjeshin dhe rrafshojnë betonin në kallëpe; të vibrojnë betonin në elementet prej b/a; të mirëmbajnë në kohën e duhur pas betonimit sipas kushteve teknike; të dizarmojnë në kohën e duhur sipas radhës elementet e kallëpeve të plintit, shtyllat, mureve b/a.

Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike si: kontrolli pozicionit të shufrave dhe shtresës mbrojtëse sipas kushteve teknike të zbatimit; pastrimi, lagja e kallëpeve dhe vendosja e lugut për betonim; përgatitja betonit me krahë/makineri sipas markave respektive (plintit, shtylla, mureve); hedhja, ngjeshja dhe rrafshimi betonit në kallëpe; vibrimi betonit në elementet prej b/a; mirëmbajtja në kohën e

duhur pas betonimit sipas kushteve teknike; dizarmimi në kohën e duhur sipas radhës të elementet të kallëpeve të plintit, shtyllat, mureve b/a.

Instrumentet e vlerësimit do të bëhen me listë kontrolli të përgatitur përpara provimit nga Komisioni.

Nxënësit në grupe ose në mënyrë individuale, vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre si: pyetje - përgjigje me gojë, vëzhgim me listë kontrolli etj. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë hartimit të listës së kontrollit të përfshihen dhe kompetencat kyçe, të tilla si angazhimi për realizimin e detyrës, pavarësia, kreativiteti, vetëkontrolli etj.

Rekomandohet që secila nga detyrat e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vete dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara në 5 (pesë) **Detyra** pune, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe nota përkatëse.